

Projekti "Ne të rinjtë"



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua një takim me studentët në bashkëpunim me përfaqësues nga media online Gogo.al, në kuadër të projektit "Ne të Rinjtë". Zëvendësrektorja e Universitetit, Prof. Elvira Fetahu në fjalën e saj përshëndetëse, theksoi rolin dhe rëndësinë e të rinjve si promotor të ndryshime në vend, për kontributin e universitetit në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm dhe si qytetar. Qëllimi i projektit është të tregojë historitë dhe përvojat e të rinjve shqiptarë, të cilat u prezantuan për studentët përgjatë takimit, duke theksuar rugëtimin e tyre, sfidat dhe arritjet në Shqipëri.

Vizitë zyrtare në Universitetin e Elbasanit e Z.Sh.T Reinout Vos



Ambasadori i Vëndeve të Ulëta në Tiranë Sh.T Reinout Vos, zhvilloi një vizitë në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ku u mirëprit fillimisht nga Zëvendësrektorja e Universitetit, Prof.Dr. Elvira Fetahu, e cila e prezantoi me historinë, kontributin dhe veprimtarinë e universitetit në vend, rajon dhe më gjerë, gjithashtu diskutuan mbi mundësitë e bashkëpunimit institucional në fushën e arsimit. Më pas Z. Vos, zhvilloi një diskutim të hapur me studentë, pedagogë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ku mundën të diskutojnë mbi procesin, rëndësinë dhe pritshmëritë e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, pa anashkaluar edhe vlerat e shtuara që Shqipëria do t'i sjellë vetë BE-së. Në fjalën e saj përshëndetëse Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit Prof. Dr. Elvira Fetahu, u ndal në rëndësinë e institucioneve të dijes, në rolin e të rinjve si ambasadorët më të mirë të një kombi, aktorët kryesorë që do të udhëheqin vendin drejt ndryshimeve të mëdha, por njëkohësisht ndërtuesit e një të ardhme më të mirë, më të drejtë dhe më të integruar në familjen e madhe evropiane.

Universiteti i Elbasanit në Kampionatin e Volejbollit



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizoi në bashkëpunim me Këshillin Studentor dhe Klubin Studentor të Sportit kampionatin e volejbollit, i cili u zhvillua midis ekipeve të krijuara nga anëtarët e këtij klubi dhe personelit administrativ në Pallatin e Sportit "Tomorr Sinani". Ky aktivitet dhe shumë të tjera të inicuar nga Këshilli Studentor dhe Klubet Studentore të Universitetit të Elbasanit, kanë si synim të kontribuojnë në ndërtimin e një komuniteti të fortë dhe të bashkuar studentësh.



Zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare Shkencore në Universitetin e Elbasanit

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua me sukses në kuadër të 30-vjetorit të hapjes së programit të studimit të Gjuhës Angleze, Konferenca Ndërkombëtare Shkencore me titull "Evolucioni Gjuhësor në Epokën Digjitale: Impakti në Komunikim, Letërsi, Qytetërim e Mësimdhënie". Kjo konferencë vjen si bashkëpunim i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Rektoratit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe institucioneve të tjera të arsimit universitar dhe parauniversitar, brenda dhe jashtë vendit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Zëvendësrektori i Universitetit, Prof.as.dr. Peçi Naqellari, shprehu rëndësinë që ka Departamenti i Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Elbasanit duke patur në përbërje personel akademik të kualifikuar, programe studimi të akredituara, si edhe një veprimtari shkencore e mësimdhënëse mjaft të integruar dhe bashkëpunuese në projekte të ndryshme me të gjitha departamentet e universitetit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në UNIEL



Ministria e Arsimit dhe Sportit, Znj. Ogerta Manastirliu, monitoroi nga afër trajnimet që zhvillohen në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" nga personeli akademik. Në vizitën e saj shoqëruar nga stafi drejtues i universitetit mundi të shkëmbente mendime e propozime me trajnuesit dhe mësuesit. Gjithashtu vlerësoi ambientet e universitetit të venë në dispozicion nga ana e universitetit për zhvillimin e këtyre trajnimeve dhe jo vetëm, duke i cilësuar si bashkëkohore.

Aktivitet nga Klubi Studentor i Sportit



Në përfundim të vitit akademik dhe për një nisje sa më të qetë të sezonit të provimeve, Klubi Studentor i Sportit realizoi disa aktivitete, përfshirë hiking dhe rafting, eksperiencë të reja për studentët. Destinacionet e tyre ishin Funari, Ujëvara e Sotirës dhe Kanionet e Holtës.